



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 17 gusht 2017
Nr. ref.:RK 1115/17

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI139/16

Parashtrues

Sefedin Jetullahu

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të
Republikës së Kosovës, Rev. nr. 168/16, të 14 korrikut 2016**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Sefedin Jetullahu (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në fshatin Vernicë, komuna e Vushtrrisë, të cilin e përfaqëson Sabri Kryeziu, avokat nga Lipjani.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin Rev. nr. 168/2016, të 14 korrikut 2016 (në tekstin e mëtejme: Vendimi i kontestuar) të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), i cili i është dorëzuar parashtruesit më 13 shtator 2016.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet shkelja e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenit 53 [Interpretimi i të Drejtave të Njeriut] dhe nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe të nenit 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt Gjyqësor] dhe të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: Konventa).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113, paragrafin (7) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 1 dhjetor 2016, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 16 janar 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Arta Rama-Hajrizi dhe Gresa Caka-Nimani.
7. Më 8 shkurt 2017, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës Supreme.
8. Më 3 korrik 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës ta deklarojë kërkesën të papranueshme, si qartazi të pabazuar në baza kushtetuese.

Përmbledhja e fakteve

9. Parashtruesi i kërkesës ka punuar disa vite në Korporatën Energjetike të Kosovës, përkatësisht në divizionin e gjenerimit-Departamenti i termocentralit Kosova B (në tekstin e mëtejme: KEK).
10. Më 18 dhjetor 2003, komisioni mjekësor i rekomandoi parashtruesit që të paraqitej pranë komisionit invalidor për të verifikuar shkallën e invaliditetit.

11. Parashtruesi, më pas, kërkoi nga autoritetet e KEK-ut që t'ia aprovonin kërkesën për njohjen e statusit të invalidit të punës dhe kërkesën për gëzimin e pensionit suplementar sipas Fondit Pensional të KEK-ut.
12. Më 9 mars 2004, KEK-u (Vendimi nr. 60/1), aprovoi kërkesën e parashtruesit për njohjen e statusit të invalidit të punës së kategorisë së parë dhe kërkesën për gëzimin e pensionit suplementar, në lartësinë prej 105 eurosh, duke filluar nga 1 marsi 2004 deri më 31 mars 2009.
13. Më 27 nëntor 2008, parashtruesi parashtrroi kërkesë te autoritetet e KEK-ut, për kthim në punë, ngase sipas tij, me Vendimin e KEK-ut nr. 60/1, të 9 marsit 2004 nuk përcaktohej statusi i tij i punës, pas 31 marsit 2009.
14. Në janar të vitit 2009, parashtruesi parashtrroi kërkesë në Departamentin e Administratës Pensionale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: DAP), për aprovimin e kërkesës së pensionit të personave me aftësi të kufizuara.
15. Më 27 shkurt 2009, DAP-i (Vendimi 5092190) refuzoi kërkesën e parashtruesit për gëzimin e pensionit të personave me aftësi të kufizuara, me arsyetimin se të i njëjti, nuk ekziston shkallë e plotë dhe e përhershme e aftësisë së kufizuar.
16. Më 14 prill 2009, parashtruesi ndaj Vendimit të DAP-it, të 27 shkurtit 2009, ushtroi ankesë në Këshillin e ankesave të personave me aftësi të kufizuara.
17. Më 27 maj 2009, Këshilli i ankesave, e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit dhe konfirmoi Vendimin e DAP-it, të 27 shkurtit 2009.
18. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi ushtroi padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë për kthim në punë ose vazhdimin e pensionit suplementar, deri në arritjen e moshës së pensionimit, përkatësisht deri më 19 mars 2016.
19. Më 2 shtator 2013, Gjykata Themelore në Prishtinë (Aktgjykimi C. nr. 109/2009), refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, duke arsyetuar si më poshtë:

“Aprovimi i kërkesës së paditësit nga e paditura KEK për pension në emër të invaliditetit ka pasur bazë juridike në Rregulloren e UNMIK-ut, nr. 2001/35 dhe në statutin e fondit pensional suplementar të vitit 2002, dispozitat nga neni 2, pika b e statutit. Nga vlerësimi i gjykatës del se baza juridike për nxjerrjen e paditësit në pension për shkak të invaliditetit në punë nga ana e të paditurës është e rregullt. Andaj gjykata vlerëson se kërkesëpadija e paditësit duhet të refuzohet si e pabazuar nga arsyet se paditësi me rastin e aplikimit në fondin pensional, i ka pasur të qarta të drejtat që mund t'i realizonte me rastin e aprovimit të kërkesës së tij për pension.”
20. Parashtruesi, brenda afatit ligjor, parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit ndaj Aktgjykimit të 2 shtatorit 2013, të Gjykatës Themelore të Prishtinës.

21. Më 24 shtator 2015, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi Ac. nr. 3870/2013), refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit dhe e konfirmoi si të rregullt dhe të ligjshëm Aktgjykimin e 2 shtatorit 2013, të Gjykatës Themelore të Prishtinës.
22. Parashtruesi ndaj Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, të 24 janarit 2015, ushtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme për shkak të aplikimit të gabuar të ligjit material.
23. Më 14 korrik 2016, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Rev. nr. 168/2016), refuzoi si të pabazuar kërkesën për revizion të parashtruesit të kërkesës dhe e konfirmoi Aktgjykimin Gjykatës së Apelit, të 24 janarit 2016 dhe Aktgjykimin e 2 shtatorit 2013, të Gjykatës Themelore të Prishtinës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta me veprimet e tyre shkelën të drejtat e tij për gjykim të drejtë, sipas nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të Konventës, mbrojtjen e pronës, sipas nenit 46 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr.1 të Konventës, si dhe të drejtat e tij të garantuara me nenin 53 të Kushtetutës, për faktin se gjykatat e rregullta gjatë gjykimin të rastit nuk morën parasysh kërkesat e dispozitave të lartcekura.
25. Për më tepër, parashtruesi kërkesës së tij ia ka bashkëngjitur Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, të 18 tetorit 2010, në rastet e bashkuara KI58/09, KI59/09, KI60/09, KI64/09, KI66/09, KI69/09, KI70/09, KI72/09, KI75/09, KI76/09, KI77/09, KI78/09, KI79/09, KI3/10, KI5/10, KI13/10.
26. Si rrjedhojë, parashtruesi kërkon që vendimi i kontestuar të shpallet i pavlefshëm dhe rasti t'i kthehet Gjykatës Supreme për rishqyrtim.

Pranueshmëria e kërkesës

27. Gjykata do të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
28. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 (7) të Kushtetutës, i cili përcakton:

“7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.
29. Gjykata, më tutje i referohet nenit 49 [Afatet] të Ligjit, i cili përcakton:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej 4 (katër) muajsh. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.
30. Lidhur me si më sipër, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar; ka shterur të gjitha mjetet juridike të disponueshme dhe ka

dorëzuar kërkesën e tij brenda afatit katër mujor në pajtim me kërkesat e nenit 49 të Ligjit.

31. Përveç kësaj, Gjykata i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili përcakton:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë”.

32. Gjykata, gjithashtu, merr parasysh rregullin 36 [Kriteret e Pranueshmërisë], posaçërisht paragrafin (1) (d) dhe paragrafin (2) (b) të Rregullores së punës, që përcaktojnë:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

(...)

(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

(...)

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese”.

(...)

33. Gjykata, rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi i kontestuar shkel të drejtat e tij të garantuara me nenet 31, 46 dhe 53 të Kushtetutës, si dhe nenin 6 dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës, megjithatë ai nuk argumenton më tej si dhe pse erdhi deri te shkelja e të drejtave të tij.
34. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës thjeshtë është i pakënaqur me rezultatin e procedurës së përfunduar në gjykatat e rregullta.
35. Në lidhje me këtë, Gjykata konsideron se fakti i thjeshtë se parashtruesit nuk i konvenon rezultati i vendimeve të gjykatave të rregullta, në veçanti i vendimit të kontestuar, nuk është i mjaftueshëm që parashtruesi i kërkesës të ndërtojë një pretendim për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës duhet që ato pretendime t'i mbështes me argumente dhe prova bindëse, në mënyrë që kërkesa të ketë sukses.
36. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve dhe se vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta, ndërsa roli i saj është vetëm ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt (Shih rastin *Akdivar kundër Turqisë*, nr. 2189/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65 dhe, po ashtu, shih rastin KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha*, Aktvendimi për pranueshmëri, i 5 prillit 2012).

37. Për më tepër, nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese ta zëvendësojë vlerësimin e vet të fakteve me atë të gjykatave të rregullta dhe, si rregull i përgjithshëm është detyrë e këtyre gjykatave që t'i vlerësojnë provat e vëna në dispozicion të tyre. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta në përgjithësi janë mbajtur në mënyrë të tillë, saqë parashtruesi i kërkesës të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejta të Njeriut, i 10 korrikut 1991).
38. Gjykata, konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk arriti të argumentojë dhe të provojë se gjykatat e rregullta kanë vepruar në mënyrë arbitrare apo të padrejtë gjatë gjykimit të çështjes së tij. Prandaj, fakti i vetëm se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë kërkesë të argumentueshme për shkelje të të drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm (shih rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).
39. Sa i përket, Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të 18 nëntorit 2010, të cilit parashtruesi i referohet, Gjykata vë në pah se në rastet e bashkuara KEK, parashtruesit e kërkesave (ish-punëtorët e KEK-ut) kërkuan nga gjykatat e rregullta që ato të vendosin për mosmarrëveshjen e tyre pronësore me KEK-un, duke iu referuar shprehimisht dispozitës së nenit 3 të Marrëveshjeve dhe duke përsëritur se Ligji për Pensionet, që themelon Fondin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor, nuk ishte miratuar ende dhe se ky fakt ishte vërtetuar nga përfaqësuesit kompetent të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Siç vërehet, nga marrëveshja e arritur me KEK-un, parashtruesit e kërkesave kanë pas pritje legjitime për gëzimin e dëmshpërblimit mujor në lartësinë prej 105 eurosh, e cila kushtëzohet me themelimin e Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor në të ardhmen. (Shih Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, *Gani Prekshi dhe 15 ish-punëtorët e tjerë të KEK-ut*, paragrafin 60, 67, 68, 70).
40. Ndërsa, në rastin e parashtruesit të kërkesës, Gjykata vëren se me Vendimin KEK-ut, të 9 prillit 2003, nuk ishte vënë kusht që realizimi i pensionit suplementar të vazhdohet deri në themelimin e Fondit Pensional dhe Invalidor. Ky vendim (marrëveshje), përmban një afat kohor të prerë sa i përket realizimit të pagesave të pensionit suplementar në lartësinë prej 105 eurosh, i cili ishte përcaktuar të përfundonte më 31 mars 2009, respektivisht pas 60 (gjashtëdhjetë) muajsh.
41. Ky dallim (kushtëzim) në rastin e parashtruesit të kërkesës është shtjelluar nga Gjykata Supreme, e cila përmend se, "... detyrimi i të paditurës (KEK-ut) në pikëpamje të kohëzgjatjes së kësaj të drejte të paditësit (parashtruesi), nuk mund të lidhet dhe të kushtëzohet me themelimin e Fondit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor...".
42. Për më tepër, Gjykata Supreme, arsyetoi: "Në bazë të marrëveshjes-vendimit të lartcekur, të cilin vendim paditësi nuk e ka kontestuar, saktësisht është përcaktuar, se kohëzgjatja e detyrimit të paditurës, që paditësit t'ia kompensojë pagesën e pensionit gjër më datën 31.3.2009, nga ana e të paditurës është përmbushur për periudhën prej 5 vjet, 60 (gjashtëdhjetë) muaj, dhe për çdo muaj në shumën prej 105 euro, ashtu siç qëndron në

vendim.” Duket qartë se parashtruesi i kërkesës në atë kohë është pajtuar me kriteret e përcaktuara nga KEK-u, sepse vendimi (marrëveshja) në fjalë nuk ishte kontestuar asnjëherë nga parashtruesi i kërkesës.

43. Në këtë aspekt, Gjykata konsideron se rastit të cilit parashtruesi i kërkesës i referohet nuk i përgjigjet rrethanave të rastit të tij.
44. Nga të gjitha rrethanat e shtjelluara si më sipër, Gjykata konsideron se faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk tregojnë që gjykatat e rregullta ia mohuan atij të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe Konventë.
45. Rrjedhimisht, kërkesa në baza kushtetuese është qartazi e pabazuar dhe si e tillë duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit dhe të rregullave 36 (1) (d) dhe 36 (2) (b), si dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 3 korrik 2017, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T’UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Ivan Čukalović



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

